



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:149058
Datë: 24.11.2022
Numri i dokumentit: 03684328

C.nr.1022/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Mirjeta Shala dhe me bashkëpunëtoren profesionale Kaltrina Halilaj, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve E.L dhe A.K, që të dy nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – DKA, të cilën me autorizim e përfaqëson i autorizuari D.B, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontestit 1,472.00 euro, jashtë seance, me datë 24 Nëntor 2022 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësve E.L dhe A.K, që të dy nga Komuna e Gjakovës dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - DKA, që :

- ◇ Paditësit E.L, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 01.09.2019 e deri me datë 01.06.2021, respektivisht për 368 ditë të pranisë në punë, të ia paguajë shumën prej 736.00.-€ (shtatëqind e tridhjetë e gjashtë euro).
- ◇ Paditësit A.K, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 01.09.2019 e deri me datë 01.06.2021, respektivisht për 368 ditë të pranisë në punë, të ia paguajë shumën prej 736.00.-€ (shtatëqind e tridhjetë e gjashtë euro).

Të gjitha shumat e lartcekura, detyrohet e paditura që të i paguajë me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloj të llogaritet nga data 08.07.2021 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - DKA, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit të ia paguaj shumën prej 228.00.-€ (dyqind e njëzet e tetë euro) në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësit E.L dhe A.K, që të dy nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, në këtë gjykatë me datë 13.07.2021, përmes të autorizuarit të tyre Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – DKA, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, duke theksuar se paditësit janë të punësuar tek e paditura, përkatësisht në shkollën “Shaban Golaj” në fshatin ..., Komuna e Gjakovës. E paditura nuk iu ka kompensuar shpenzimet për ushqimin në punë, andaj kanë paraqitur padi ku kanë kërkuar nga gjykata që të detyrojë të paditurën që të bëjë pagesën e kompensimit për ushqim me kamatë ligjore si dhe shpenzimet procedurale. I autorizuari i paditësve përmes parashtrësës ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, ashtu që për periudhën kohore nga data 01.09.2019 deri me datë 01.06.2021, ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësve secilit veç e veç për 368 ditë të iu paguajë nga 736.00 euro, ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura përmes përfaqësuesit të autorizuar D.B në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 30.05.2022, me të cilën ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve pasi që MASHT-i dhe SBASHK-u, nuk janë të angazhuar për t’i informuar dhe ndihmuar Komunitat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston buxhetore për zbatimin e kësaj kontrate në Ministrinë e Financave me qëllim të realizimit të buxhetit etj., ashtu që ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditësës ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësin A.K të lëshuar nga Komuna e Gjakovës – DKA, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, e vërtetuar me Leg.nr.1811/2021 me datë 01.06.2021, Kontrata e punës për paditësin A.K, e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – DKA, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, e vërtetuar me Leg.nr.1785/2021 me datë 31.05.2021, Kontrata e punës për paditësin E.L, e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – DKA, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, e vërtetuar me Leg.nr.1797/2021 me datë 31.05.2021, Kontrata e punës për paditësin E.L, e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – DKA, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, e vërtetuar me Leg.nr.1796/2021 me datë 31.05.2021, paditësit e lartcekur janë në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Shaban Golaj” në fshatin ..., Komuna e Gjakovës, si punëtor tekniko-shërbyes dhe se bazuar në Vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me numër të protokollit 245 të lëshuar nga drejtori i shkollës fillore “Shaban Golaj” në fshatin ..., Komuna e Gjakovës e datës 01.06.2021, në periudhën prej datës 01.09.2019 deri me datë 01.06.2021, paditësi kanë punuar secili nga 368 ditë pune. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar

ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e dy Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe ajo e vitit 22.01.2021, sepse kërkesa për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë për vitin 2020 mbulohet nga kontrata kolektive e datës 18.04.2017 e ndërsa pjesa tjetër për vitin 2021, mbulohet me kontratën kolektive të datës 22.01.2021.

Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditëseve nuk iu ka paguar shpenzimet e ushqimit të parapara me nenin 35 par.7 të dhe asaj të datës 22.01.2021, ku është përcaktuar se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim pagese (2 euro), të të punësuarve për ushqim për t’u bërë kompensimin”*, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e themeltë, andaj në rastin konkret gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Në ndërlidhje me dispozitat e lartcekura, gjykata erdhi në përfundim se nuk është kontestuese gjendja faktike në mes të palëve ashtu që konform nenit 35 par.7 të KKAK-së, paditësve iu takon e drejta në kompensimin e shpenzimeve të ushqimit ashtu që gjykata lidhur me këtë bëri përllogaritjen në atë mënyrë që ditët e pranisë në punë i ka shumëzuar me 2, duke iu njohur shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pretendimin e të paditurës dhënë në përgjigje në padi se nuk ka planifikim buxhetor për këto kompensime, i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme dhe i vlerëson si të parëndësishme për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestuese, pasi që paditësi nuk është përgjegjës për planifikimin e buxhetit për obligimet që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e lartcekur, andaj edhe rrethanat subjektive të të paditurës lidhur me mos planifikimin me kohë të buxhetit për zbatimin e kontratës së lartcekur nuk e liron të njëjtën nga detyrimi për pagesën e këtyre shpenzimeve.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, u muar sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç ‘rast paditëses iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 228.00.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në

vlerë prej 20.00.-€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), si dhe për përpilimin e padisë shuma prej 104.00.-€, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17), si dhe shpenzimet për përpilimin e parashtrësës për precizimin e padisë në shumën prej 104.00.-€.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1022/21 datë 24 Nëntor 2022

Gj y q t a r j a,
Mirjeta Shala

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.